



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës
Opština Priština – Municipality of Prishtina

Në bazë të nenit 43, paragrafi 43.1 i Ligjit nr. 03/L -040, për vetëqeverisje lokale (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës”, nr. 28/15, qershor 2008) dhe të nenit 5 të Udhëzimit administrativ (MAPL) nr. 02/2015, për mbajtjen e mbledhjeve të Kuvendit të Kryeqytetit, kryesuesi i Kuvendit të Kryeqytetit

th ë r r e t

mbledhjen e **parë** të Kuvendit të Kryeqytetit të Republikës së Kosovës, e cila do të mbahet më **31.1.2025** dhe do të fillojë në orën **10:00**.

Mbledhja do të mbahet në sallën e madhe të Kuvendit të Kryeqytetit, rr. “UÇK”, nr. 2.

Për mbledhje propozon këtë

REND TË DITËS:

1. Miratimi i ekstrakteve të procesverbaleve të seancave të jashtëzakonshme dhe të seancës së nëntë të Kuvendit të Kryeqytetit;
2. Propozim-vendimi lidhur me Planin lokal të veprimit për barazi gjinore 2024-2026;
3. Propozim-vendimi për formimin e grupit punues për hartimin e Planit vjetor të punës së Kuvendit për vitin 2025;
4. Propozimvendimi për hartimin e Planit të hollësishëm rregullues Çagllavicë;
5. Propozimvendimi për fillimin e revidimit të Planit rregullues të hollësishëm Zona Ekonomike;
6. Propozim-vendimi për përkrahje financiare për familjet strehuese dhe fëmijët në strehim familjar;
7. Propozim-vendimi për vënien në diskutim publik të Strategjisë së Prishtinës për artin dhe kulturën 2026-2031;
8. Propozim-vendimi për caktimin e lokacionit për ndërtimin e institucionit parashkollor dhe caktimi i lokacionit për ndërtimin e objektit të kultit – xhamisë në fshatin Orlloviq, të komunës së Prishtinës;
9. Propozim-vendimi për miratimin e projektregullores për subvencionet e Komunës së Prishtinës;

Faqe 1 nga 2

10. Propozim-vendimi për miratimin e kërkesës së përfaqësuesve të lagjes “Kodra e Diellit II”, për themelimin e komisionit për vlerësimin dhe shqyrtimin e Aktvendimit mbi eksproprijim, nr. 07. nr. 465-25/85, të datës 8 korrik 1985;
11. Pyetje dhe përgjigje;
12. Të ndryshme.

KUVENDI I KRYEQYTETIT
01-060/01-6867/25, më 14.1.2025

KRYESUESI I KUVENDIT

Fehmi Kupina

